



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	06.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	7339/2023	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK			119



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1260/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj, Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbaitëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1260/2023, të datës 06.10.2023, të parashtruar nga ankuesi nga Gjilani kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike „masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.12.2023, me shumicë votash mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1260/2023, e datës 06.10.2023, e parashtruar nga ankuesi

**II. Anulohet** masa disiplinore “Vërejtje”, e shqiptuar ndaj ankuesit përmes Vendimit me Nr.0918/23 të datës 08.08.2023, të Zëvendësuesit të Mbikëqyrësit të Lartë, në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan/Shërbimi Korrektues i Kosovës.

**III. Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e ankuesit dhe regjistri përkatës masën disiplinore “Vërejtje”, e anuluar si në pikën II të dispozitivit.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Nëpunësi civil (tutje referuar ankuesi), më datë 06.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1260/2023, kundër Vendimit me numër 0918/23 të datës 08.09.2023 lidhur me shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje”, dhe me pretendimet ankimore se masa e dhënë është plotësisht e pa bazuar dhe e pa argumentuar si dhe e njëjta është dhënë nga zv. Mbikëqyrësi i Lartë është jashtë kompetencës ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 30.11.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokoll 7014/2023, të datës 16.11.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1260/2023, të datës 06.10.2023.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 6420/2023 të datës 06.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 0918/23 të datës 08.09.2023 lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.10.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 30.11.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe atë: Kontratën e punës së ankuesit për kohë të pacaktuar 13.06.2018; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 03.01.2020; Kontratën e punës për G.D për kohë të pacaktuar të datës 22.03.2022 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 03.01.2020; Vendimin me Nr.324 të datës 16.03.2023 lidhur me caktimin e G.D si zëvendësues i Mbikëqyrësit të Lartë; Shkresën zyrtare me numër 979 të datës 26.07.2023 nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë; Deklaratën e ankuesit të datës 26.07.2023 rreth rastit i cili është kontestues sipas ankesës në Këshill; Inicimin e procedurës disiplinore me Nr.KD.nr.051 të datës 28.07.2023 NGA Udhëheqësi për Siguri në Gjilan; Vendimin me numër KD.nr.051/2023 të datës 24.08.2023 të Komisionit Disiplinor në SHKK; Raportin e datës 27.07.2023 të Udhëheqësit për Siguri në SHKK-Qendra e Paraburgimit në Gjilan; Shkresën zyrtare të datës 23.07.2023 lidhur me raportimin e incidentit nga ankuesi; Listën e hyrjes në punë të datës 23.07.2023 në Qendrën Korrektuese në Gjilan; Shkresën zyrtare të datës 26.07.2023 lidhur me raportin e deklaratës nga SH.M në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan si dhe Vendimin me numër protokoll 7014/2023 të datës 16.11.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill, emaili i datës 05.12.2023 nga Drejtori i SHKK-së për KPMSHCK-në.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit ..... është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës ( tuje SHKK) dhe se i njëjti sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 13.06.2022, ushtron pozitën e punës “Mbikëqyrës” në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë me datë 26.07.2023, ka nxjerr Raport lidhur me hetimin e rastit të datës 23.07.2023, të vetëlëndimit të të paraburgosurit me inicialet D. B. në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, duke rekomanduar që ndaj ankuesit të iniciohet procedurë disiplinore, me arsyetimin se pasi që në raportet zyrtare ka mos përputhje të intervalit kohor gjatë kohës së përcjelljes së të paraburgosurit jashtë institucionit. Tutje, Udhëheqësi për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, përmes shkresës zyrtare me Nr.KD/051 të datës 28.07.2023, ka iniciuar ndaj ankuesit procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor të SHKK-së, ndërsa, ky i fundit me Vendimin me numër KD.nr.051/2023 të datës 24.08.2023, ka kthyer çështjen në rivlerësim.

Me datë 08.09.2023, Zëvendës Mbikëqyrësi i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, duke u bazuar në Raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë të datës 26.07.2023 lidhur me rastin e të burgosurit D.B, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore “Vërejtje”, për shkak të shkeljes disiplinore sipas nenit 46 paraf 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, me arsyetimin se me veprimet e tij si Mbikëqyrës nuk ka qenë efikas dhe ka shkaktuar vonesa në punë dhe se i njëjti ka raportuar në mënyrë jo të adekuate dhe jo të saktë për incidentin e ndodhur me çka ka shkaktuar konfuzion tek eprorët.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se masa disiplinore e kundërshtuar me ankesë është plotësisht e pa bazuar, e pa argumentuar dhe se është jashtë kompetencës ligjore, për shkak se në kohën kur ka ndodhur incidenti zëvendës Mbikëqyrësi i Lartë G.D ka

qenë në pushim vjetor dhe se pas kthimit nga pushimi ka marrë vendim për shqiptimin e së njëjtës, po ashtu thekson se shkelja e supozuar sipas raporteve zyrtare të përpiluara lidhur me rastin e vetëlëndimit të paraburgosurit D.B ka ndodhur me datë 23.07.2023 e jo siç pretendohet në vendim se ka ndodhur me datën 23.08.2023. Thekson se rasti i të burgosurit është menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe se nuk ka pasur as më të voglën shkelje sa i përket procedurave të punës. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj vendimin për shqiptimin e masës disiplinore “vërejtje” të datës 08.09.2023.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ( në fuqi në kohën e shqiptimit të masës disiplinore) që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht: Nenit 45, me të cilin është përcaktuar se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”*. Nenit 46, me të cilin është përcaktuar se: *“... Shkeljet disiplinore 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar”*. Nenit 47 paragrafin 1, me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: *“Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”*. Nenit 48, me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore *“1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.*

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, Kolegji ka analizuar vendimin e atakuar me ankesë në ndërlidhje provat materiale të çështjes, dhe si rrjedhojë Kolegji ka gjetur së Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e nxjerrjes së vendimit të atakuar me ankesë dhe Inspektorati i Ministrisë në Raportin e datës 26.07.2023, nuk kanë vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë faktet relevante lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit, dhe në këtë mënyrë gabimisht është zbatuar e drejta materiale. Rrjedhimisht, që të dy organet nuk kanë vërtetuar intervalin kohor të vonesës së ankuesit për bartje dhe dërgimin e të paraburgosurit të rastit, gjegjësisht në rastin konkret organet në fjalë kishin dështuar në vërtetimin e intervalit kohor nga koha kur ankuesi kishte telefonuar personat përgjegjës për transport të të paraburgosurit për në Emergjencë, (pra kur ankuesi kishte bërë njoftimin e zyrtareve për transport) deri në kohën e arritjes së njësisë për transport, periudhë kohore kjo nga konstatimi i së cilës do të vërtetohej edhe vonesa e ankuesit në përmbushje të detyrës së punës. Po ashtu, Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, përkundër evidentimit në raportin e rastit të datës 26.07.2023,

se janë administruar edhe dëshmitë mjekësore, në asnjë rrethanë nuk ishin dhënë vlerësime nëse natyra e lëndimit, të të paraburgosurit nuk ka lejuar vonesa dhe si e tillë do të paraqiste rrezik për shëndetin e të paraburgosurit, edhe pse në deklaratimet e ankuesit është thënë se gjendja e të paraburgosurit ka qenë e mirë dhe së i njëjti nuk ka pas dhimbje.

Ndërlidhur me konstatimin si më sipër, dhe përkundër kërkesës së Këshillit, organi i punësimit nuk ka arritur të ofroj dëshmi të regjistrimit të thirrjes se ankuesit për njoftimin e zyrtareve gjegjës për transport të të paraburgosurit, dëshmi të regjistrimit të arritjes së njësisë së transporti dhe si dhe dëshmitë mjekësor nga mjeku ambulator, prova këto nga të cilat do të vërtetohej pretendimi për vonesë të ankuesit në drejtim të trajtimit të rastit ashtu sikurse është theksuar në arsyetimin e raportit të datës 26.07.2023, të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, Raportit të datës 27.07.2023 nga Udhëheqësit për Siguri si dhe në vendimin e kontestuar me ankesë, andaj, në mungesë të këtyre provave Kolegji konstaton se organi i punësimit ka dështuar që të argumentoj se në veprimet e ankuesit janë plotësuar elementet e përgjegjësisë disiplinore siç përcaktohet me nenin 45 të Ligjit 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku parashihet se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit...* Rrjedhimisht, Kolegji thekson faktin se Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë në vet raportin e datës 26.07.2023, ka konstatuar se citojmë: *"...trajtimi mjekësor...përkundër faktit që ka qenë i vonuar nuk ka shkaktuar pasoj që ka rezultuar dhe u argumentua në rrezik potencial shëndeti dhe siguria e të paraburgosurit..."* kështu që, mbi bazën e këtyre rrethanave dhe konstatime, rezulton janë të bazuar pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin e ankuesit për jo kompetencë të Mbikëqyrësit të Lartë G. Dërmaku, për shqiptimin e masës disiplinore të kontestuar, konstaton ky pretendim nuk është i qëndrueshëm dhe nuk konsiderohet si relevant për vendosje meritore të kësaj çështje juridiko-administrative, për faktin se bazuar në shkresat e lëndës rrjedhë sa Mbikëqyrësi Lartë G. Dërmaku është epror i drejtpërdrejt i ankuesit.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1260/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.